



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Datë/A:	14.07.2025
Për/Za/To:	Bashkim Ramosaj- Kryetar i Komunës Zyra e Koordinatorës Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
Nga/From/Od : Përmes:	Ajne Iberhysaj- Koordinautore Komunale Kundër Dhunës në Familje <i>Ajne</i>
Tema/Subject/Subjekt	Raporti për periudhën Janar- Qershor - 2025


Komuna e Deçanit duke u bazuar në Ligjin me Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore si dhe Rregullores (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, e miratuar me Vendimin Nr.01/249, të datës 26.02.2025 ku Komuna e Deçanit ka të themeluar Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ndaj Grave me 10 Dhjetor 2023, po ashtu ka të miratuar nga Asambleja Komunale strategjinë Komunale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027

Duke u bazuar sipas dispozitave ligjore dhe rregullores të përmendur me lartë Mekanizmi Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj grave në Baza Gjinore drejtohet nga Kryetari i Komunës, ndërsa për mbështetje administrative dhe teknike, është caktuar Znj. Ajne Iberhysaj, zyrtare për barazi gjinore, si Koordinautore Lokale dhe Sekretare e Mekanizmit.

Bazë Ligjit më Nr. 08/L-185 dhe Rregullores me Nr. 01/2025; Mekanizmi Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj grave në Baza Gjinore, **Komuna e Deçanit ka mbajtur dy takime dhe një punëtori me Rrjetin "Qeliza" me seli në Gjakovë dhe janë:**

- Takimi i parë u mbajt më datë 30 maj 2025 Nr. protokollit: 02/12652

Në këtë takim të Mekanizmit kanë marrë pjesë anëtarë të mekanizmit lokal po ashtu duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, kanë marr pjesë në Mekanizmin Koordinues Lokal edhe përfaqësues nga mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave; Përfaqësues nga Policia; Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas; Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor; Strehimorja në Pejë; Institucioni i Avokatit të Popullit i



përfaqësuar nga këshilltarja e lartë Juridike; OSBE; Përfaqësuesja e Shërbimit Sprovues me seli në Pejë;

Tema: Hartimi i Planit të Punës për vitin 2025, prioriteti i aktiviteteve si dhe koordinimi ndërinstitutional

Gjatë takimit, u prezantua Plani i Aktiviteteve për vitin 2025, ndërsa z. Xhavit Nimonaj përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Deçan raportoi për rastet e dhunës në familje të raportuara deri në këtë fazë të vitit. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse kontribuan me mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës për viktimat e dhunës.

Kurse Dr. Nusret Pepaj përfaqësues nga shëndeti mendor, propozoi organizimin e një trajnimit për zyrtarët përkatës me temën: “Si të merret një deklaratë nga një person që ka përjetuar dhunë”, si pjesë e përpjekjeve për rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të tilla. Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët për zbatimin e Planit të Veprimit Lokal për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje dhe në Baza Gjimore në Komunën e Deçanit.

Gjatë takimit përfaqësuesi i stacionit të policisë z. Xhavit Nimonaj, raportoi për rastet e raportuara të dhunës në familje që janë 13 raste dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Të gjitha institucionet kontribuan me ide dhe propozime për forcimin e bashkëpunimit.

Linku i takimit i publikuar ne ueb faqen komunale:

<https://decan.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-i-mekanizmit-koordinues-kunder-dhunes-ne-familje-ndaj-grave-dhe-ne-baza-gjinore/>

- **Takimi i dytë i Mekanizmit është mbajt me datë 25.06. 2025 nr. të protokollit 02/15503**

Tema: Intervistimi i viktimës së dhunës në familje. Ligjërues: Dr. Nusret Pepaj – specialist i shëndetit mendor

Ky takim kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndjeshmërisë institucionale për trajtimin e rasteve të dhunës, me theks në intervistimin etik dhe të

kujdesshëm të viktimës së dhunës në familje. Dr. Pepaj paraqiti format e dhunës dhe ndikimin e tyre në shëndetin emocional të viktimës. U theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe respektimi i dinjitetit të viktimës. Pjesëmarrës në këtë trajnim: përveç përfaqësuesve të mekanizmit lokal ishin edhe përfaqësues nga stacioni i policisë Deçan, zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, gjykata themelore Pejë, dega në Deçan, qendra për Strehim të Viktimave- Pejë.

Qëllimi i takimit ishte rritja e ndjeshmërisë institucionale dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale në raport me intervistimin etik, të kujdesshëm dhe të ndjeshëm të viktimave të dhunës në familje, me theks të veçantë në dhunën psikologjike si formë e shpërfillur por thellësisht e dëmshme që do shumë kujdes trajtimi i rasteve.

Ligjërues në trajnim ishte Dr. Nusret Pepaj, specialist i shëndetit mendor, i cili trajtoi temat si:

- Format e dhunës (fizike, psikologjike, ekonomike, seksuale)
- Shkaktarët e dhunës psikologjike (mungesa e vetëkontrollit, kultura patriarkale, përvoja të mëparshme dhune, varësitë, varësia emocionale)
- Pasojat emocionale dhe psikologjike tek viktimat
- Qasja terapeutike dhe ndërhyrjet institucionale
- Etika dhe ndjeshmëria gjatë intervistimit të viktimës

Në përfundim të këtij takimit u kërkuar për një qasjeje më të ndjeshme dhe të koordinuar ndaj viktimave të dhunës në familje. Dhuna psikologjike, edhe pse më pak e dukshme, lë plagë të thella dhe kërkon ndërhyrje gjithëpërfshirëse për ta ndalur ciklin e saj. Përmes bashkëpunimit ndërinstitutional dhe fuqizimit të kapaciteteve, Komuna e Deçanit po dëshmon përkushtim për një mjedis më të sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100063777511208>

Punëtori me Mekanizmin Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Deçanit (24 shkurt 2025)

Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Deçanit, në bashkëpunim me Rrjetin “Qeliza” nga Gjakova, organizuan më **24 shkurt 2025** një **punëtori** me pjesëmarrjen e anëtarëve të **Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje** si dhe akterëve të tjerë relevantë lokalë.

Kjo punëtori u realizua në kuadër të projektit **“Së bashku mundemi: Shpresë dhe Ndryshim”**, dhe u koordinua nga **Znj. Ajne Iberhysaj**, zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Deçanit, në cilësinë e **Koordinatorës Lokale dhe Sekretares së Mekanizmit**.

Nën udhëheqjen profesionale të trajnerit **Arbnor Pula**, pjesëmarrësit diskutuan mbi funksionimin e **Mekanizmit Koordinues Komunal**, rishikuan **Planin e Veprimit për vitin 2025**, si dhe identifikuan sfidat që duhet adresuar për të përmirësuar ndërhyrjet institucionale kundër dhunës në familje.

Përmes një bashkëbisedimi të hapur dhe konstruktiv, u dhanë rekomandime të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përmirësimin e shërbimeve të mbështetjes për viktimat.

Ky aktivitet u realizua si pjesë e një **nën-granti të Programit EU-CERV**, i mbështetur nga **Ecumenical Women’s Initiative (EWI)** dhe zbatuar nga Rrjeti “Qeliza”.

Zyra për Barazi Gjinore falënderon **z. Faik Jahmurataj**, komandantin e Stacionit të Policisë në Deçan, si dhe të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe kontributin e tyre në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë qytetarët.

Statistika të dhunës në familje për periudhën janar-qershor 2025:

Sipas të dhënave nga **Stacioni i Policisë në Deçan**, për periudhën **janar-qershor 2025**, janë raportuar gjithsej **13 raste të dhunës në familje**, prej të cilave:

- **9 raste** me viktimë gra
- **4 raste** me viktimë burra

<https://decan.rks-gov.net/news/punetoria-mbi-planin-e-veprimit-kunder-dhunes-ne-familje-ne-komunen-e-decanit/>